



Data: _____

TVSH - ILP

Formulari i Aplikacionit për “Lirimet në importim me rastin e importimit të lëndës së parë”

Sqarim:

Ky aplikacion është i bazuar në Ligjin për TVSH nr. 05/L-037, nenit 29.1.11. dhe Udhëzimit Administrativ të këtij ligji Nr. 03/2015, nenit 48, paragrafët 1, 2 dhe 3, si dhe Vendimeve të Qeverisë Nr. 13/2017 të datës 06.10.2017 dhe Nr. 14/2017 të datës 06.10.2017. Sipas nenit 29, paragrafit 1, nënparagrafët 1.11. pika “a” të këtij Ligji për TVSH, me rastin e importimit, lirohen nga TVSH lënda e parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit. Lirimi do të lejohet vetëm për bizneset të cilat zhvillojnë aktivitet prodhues.

Më qëllim të përfitimit nga ky lirim, tatimpaguesi duhet të parashtror këtë kërkesë- aplikacion pranë Administratës Tatimore të Kosovës. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015, neni 48.2. me “lëndë të parë” kuptohen mallrat e blera të cilat do të hyjnë në prodhim dhe do të transformohen në produkte finale.

Nëse, aplikuesi në të njëjtën kohë importon mallra të njëjta, ku një pjesë e tyre konsiderohet si “lëndë e parë” për nevoja të importuesit, kurse pjesa tjetër do të shërben për qëllime tregtare për shitje të mëtutjeshme, lirimi nga TVSH-ja në import sipas dispozitave ligjore të lartëpërmendura do të bëhet vetëm për sasinë e konsideruar si “lëndë të parë”, kurse për pjesën tjetër të sasisë duhet të ngarkohet dhe të paguhet TVSH-ja në import.

Tatimpaguesi si aplikues me këtë formularë bartë përgjegjësinë e plotë ligjore mbi saktësinë dhe korrektesinë e deklaratës së tij të plotësuar në këtë aplikacion dhe për dokumentet e bashkangjitura sipas kërkesave ligjore të lartëpërmendura. Nëse, nga Organet Tatimore dhe Doganore pas importimit konstatohet se, mallrat e importuara si “lëndë e parë” nga tatimpaguesi nuk janë përdorur për qëllime prodhuese sipas dispozitave ligjore dhe akteve tjera nënligjore të lartëpërmendura, por për qëllime tjera, si ato tregtare, të rishitjes etj., atëherë do të njoftohet Dogana e Kosovës për ngarkimin e detyrimeve të TVSH-së në ato mallra për periudhën tatimore kur edhe ka ndodhur importi i tyre, kurse nga organi i ATK-së do të ngarkohen detyrimet tatimore me të gjitha ndëshkimet dhe intereset.

Aplikacioni dorëzohet:

- Për herë të parë
 Shtesë
 Korrigjim

Informatat e përgjithshme mbi aplikuesin:

Emri i Tatimpaguesit:

NUI:

Adresa e plotë:

Numri i telefonit:

E-mail adresa:

Pronari/Menaxheri:

Emri i Tatimpaguesit:	
NUI:	
Adresa e plotë:	
Numri i telefonit:	
E-mail adresa:	
Pronari/Menaxheri:	

1 .Përshkrimi i veprimtarisë /ve afariste:

a.

b.

(p.s. nëse ka të tjera, bashkangjitë aplikacionit përshkrimin sipas kësaj pike)

2. Kodi/et i/e regjistruar/a i/të veprimtarisë afariste sipas ARBK:

Kodi:

3. Në aneksin e këtij aplikacioni, në mënyrë tabelare plotëso saktësisht kodet doganore - nr. tarifor dhe përshkrimin e mallrave si “lënden e parë” që do të importohen. *(Shih aneksin në faqen tjetër)*

4. Bashkangjit dokumentet si shtojca të këtij aplikacioni, sipas kërkesave të nenit 48.4.3. të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015, si:

- a. Çertifikata e regjistrimit të biznesit me informatat mbi veprimtarinë e prodhimit;
- b. Çertifikata e regjistrimit në TVSH (nëse është Deklarues I TVSH-së);
- c. Planin vjetor të prodhimit;
- d. Normativin me specifikat për secilin element që përdoret në procesin e prodhimit duke identifikuar produktin final me specifikat teknike të tij, etj. Për çdo ndryshim në lidhje me këtë nënparagraf duhet të njoftohet komisioni përkatës në ATK.

Emri dhe mbiemri si dhe nënshkrimi i aplikuesit:

Data e aplikimit:

Vërrejtje për aplikantin:

Për mosplotësim korrekt apo edhe të saktë të të gjitha kërkesave të lartpërmendura, apo edhe për mosbashkangjitje të dokumenteve shitesë të kërkuara sipas pikes 4 të këtij aplikacioni do të konsiderohet si i kërkesë e pakompletuar dhe do të refuzohet si i tillë.

NORMATIVA E PRODHIMIT

Ky dokument plotësohet në bazë të kërkesave të nenit 48.3.2.5. të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015, lidhur me lirimet në importim të “lëndës së parë” që shfrytëzohen për procesin e prodhimit, citat: “Normativin me specifikat për secilin element që përdoret në procesin e prodhimit duke identifikuar produktin final me specifikat teknike të tij, etj. Për çdo ndryshim në lidhje me këtë nënparagraf duhet të njoftohet komisioni përkatës në ATK.”

Nëse ka ndonjë specifikë që nuk është paraparë sipas kësaj tablele të normativave të prodhimit për njësi prodhuese (shih në faqet vijuese), duhet të shënohen në faqet shtesë dhe i bashkangjiten këtij dokumenti si të vërtetuar.

Për çdo produkt final që prodhohet me specifikat e saja teknike duhet të plotësohet ndarazi “normativi i prodhimit”.

Në dokumnetin e “normativave të prodhimit”, nr. tarifor “hyrës” (të mallrave që importohen si lëndë e parë) dhe nr. tarifor “dalës” (nr. tarifor i mallrave që prodhohen si “produkt final”) duhet të shënohen nga Nomenklatura e Sistemit të Harmonizuar të Mallrave - TARIK. Nr. tarifor “hyrës” dhe nr. tarifor “dalës” nuk mundën me qenë të njëjta për qëllime të këtyre dispozitave të lartpërmendura, sepse duhet konsideruar se mallrat që hyjnë në proces të prodhimit si lëndë e parë duhet të transformohen në produkte tjera si produkte finale dhe kanë nr. tarifor të ndryshëm.

Çmimet shitëse të produkteve finale mbahen në regjistrat e kontabilitetit të biznesit dhe varësisht nga lëvizjet në treg të çmimit të mallrave të prodhuara sipas kësaj “normative të prodhimit” jepen sqarimet dokumentare gjatë inspektimeve tatimore.

Biznesi në emrin e të cilit plotësohet ky dokument sipas dispozitave të lartpërmendura, bartë përgjegjësinë e plotë për saktësinë dhe korrektësinë e deklarimeve.

(shih në faqen tjetër në vazhdim - tabelën për plotësim)

NORMATIVA E PRODHIMIT

(bazuar në nenin 48.3.2.5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015)

Emri i BIZNESIT:

NUI:

Adresa e plotët:

- Përshkrimi i mallit që prodhohet:
- Emri tregtar i mallit:
- Numri tarifor "dalës" (kodit doganor):
- Njësia matëse:
- Sasia e prodhuar për një njësi matëse:

Nr. Tarifor "hyrës" (për mallrat që importohen), kurse për blerjet vendore nuk shenohet nr. tarifor	Përshkrimi i mallrave si lëndë e parë që hyjnë në proces të prodhimit.	Njësia matëse	Sasia	Vërejtje:
1	2	3	4	5

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës:

Nënshkrimi, data dhe vula e fëmës:

PLANI VJETOR I PRODHIMIT

Ky dokument plotësohet në bazë të kërkesave të nenit 48.3.2.4. të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015, lidhur me lirimet në importim të “lëndës së parë” që shfrytëzohen për procesin e prodhimit. Plotësimi si në vijim i kësaj tabele bazohet në dokumentet e normativave të prodhimit sipas nenit 48.3.2.5 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Planit vjetor të prodhimit, të shprehur në mënyrë vlerore mund t'i bashkangjitet këtij dokumenti ndarazi, apo edhe të jetë pjesë integrale e tabelës së pasqyruar. Poashtu, “planit vjetor” i prodhimit sipas rrethanave të biznesit mund të jetë i zbërthyer (detajizuar) edhe në muaj, tremujor etj. të vitit kalendarik, por gjithmonë duke patur parasyshë vitin kalendarik si kumulativ i “planit vjetor”, por edhe me specifika tjera relevante të veprimtarisë ekonomike prodhuese.

(shih në faqen tjetër në vazhdim - tabelën për plotësim)

PLANI VJETOR I PRODHIMIT, PËR VITIN

(bazuar në nenin 48.3.2.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015)

Emri i BIZNESIT:

NUI:

Adresa e plotët:

PLANI VJETOR I PRODHIMIT, PËR VITIN <input type="text"/>						
Nr. rendor	Nr. Tarifor "i mallrave që prodhohen, (bazuar në "normativat e prodhimit")"	Përshkrimi i mallrave që prodhohen me specifikat e saja (bazuar në dokumentin e normativave të prodhimit).	Njësia matëse	Produkti që prodhohet me specifikat e saja teknike sipas "normative të prodhimit".	Planifikimi vjetor i sasisë, apo numri i produkteve të prodhuara	Vërejtje eventuale
1	2	3	4	5	6	7
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës:

Nënshkrimi, data dhe vula e fimes: